

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“Blerje shërbimi, përgaditjen e dokumentacionit dhe ricertifikimi ISO 14001, për sistemin e menaxhimit Mjedisor për OST sh.a. (Aparatin Qendror, Njësitë Operative dhe NJMT)”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

79130000-4 - Shërbime të dokumentimit dhe çertifikimit ligjor.

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

1,700,000 (një milion e shtatëqind mijë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **“Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 680,000 (gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) Lekë.*

*Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

*Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë shërbimin objekt procedure prokurimi dhe shtrirjen gjeografike territoriale ku do të realizohet kontrata, kerkohet qe OE ofertues te paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlere e xhiros te jete ne masen 680,000 (gjashtëqind e tetëdhjetë mijë ) Lekë.

---

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 340,000 (tre qind e dyzet mijë) Lekë pa TVSH.*

*Lidhur me këtë pikë:*

*Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlere, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore e shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

**Shënim:** *Operatori Ekonomik ofertues duhet te paraqesë shembuj te certifikimit sipas standardit ISO 14001.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë shërbimet objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

---

2.3.2 *Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i akredituar nga enti i akreditimit shtetëror shqiptar, ose organizma ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si trupe certifikuese të sistemeve të menaxhimit sipas standardit ISO/IEC 17021, kundrejt standardit ISO 14001. Ky kriter duhet dëshmuar me certifikate leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga ente akredituese ndërkombetare të njohura në Republikën e Shqipërisë.*

**Argumentimi:** Operatori ekonomik të jetë i akredituar dhe i kontrolluar nga ente certifikuese për shërbimet e konsulencës, implementimin apo certifikimin të standardeve ISO 14001, kjo jep siguri për ne si Autoritet Kontraktor që shërbimi i kërkuar do të kryhet me sukses. Ky kriter është bazuar në nenin 44, pika,1 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.3 *Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të paktën 1 (një) Lead Auditor për Auditimin e sistemit ISO 14001, të angazhuar për realizimin e procedurave të prokurimit. Kjo e vertetuar nga dokumentacione të ndryshme (trajtime, eksperiencë pune, CV, vërtetime nga kompani të ndryshme, libereze pune, listepagesen e fundit e-sig).*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përparë publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Qëllimi i shërbimit do jetë blerje shërbimi, përgaditje e dokumentacionit dhe ricertifikimi ISO 14001, për këtë arsye është e domosdoshme paraqitja e të gjithë kapacitetit të kualifikimit dhe disponibilitetit të Lead Auditoreve të Certifikuar për standardin ISO 14001. Vërtetimi që ky person të ketë paraqitur kualifikimet dhe certifikimet e duhura për të kryer punën e një Auditori kryesor për standardin ISO 14001, jep siguri maksimale. Sisteme që kërkojnë

impenjim dhe persona te kualifikuar maksimalisht, duke qese se jemi tek Operatoret Kritike te Informacionit. Ky kriter eshte bazuar ne nenin 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

*2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet te kete ne stafin e tij nje ekspert i cili duhet te kete eksperience lidhur me trajnimet dhe certifikimet ISO, duke deshmuar qe eshte Trajner dhe Auditor ne trupa certifikuese te akredituara sipas ISO 17021. Kjo duhet te vertetohet nepermjet references nga Trupa Certifikuese te Akredituara sipas ISO 17021, te cilat konfirmojne qe ky ekspert kryen auditime per standardin ISO 14001.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

**Argumentimi:** Qëllimi i shërbimit do jetë blerje shërbimi, përgaditje e dokumentacionit dhe ricertifikimi ISO 14001, per kete arsye eshte e domosdoshme paraqitja e te gjithë kapacitetit tek kualifikimi dhe disponibiliteti i ekspertit te Certifikuar per standardin ISO 14001. Vertetimi qe ky ekspert te ketë paraqitur kualifikimet dhe certifikimet e duhura per te kryer punen e nje Auditori kryesor per standardin ISO 14001, jep siguri maksimale. Sisteme qe kerkojne impenjim dhe persona te kualifikuar maksimalisht, duke qese se jemi tek Operatoret Kritike te Informacionit. Ky kriter eshte bazuar ne nenin 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

*2.3.5 Ofertuesi ekonomik duhet të paraqesë një përshkrim të përafërt të metodologjisë, planit të punës dhe afateve kohore për zbatimin e kontratës, duke përfshirë udhëtimet ne NJO, nënstacionet e OST sh.a, duhet të realizoje asistimin dhe përgatitjen e dokumentacioneve për SMM, duke kryer konsultime të vazhdueshme me stafin e OST sh.a për plotësimin e procedurave e të dokumentacioneve sipas Standardeve ISO 14001: dhe ne përputhje me legjislacionin ne fuqi.*

**Argumentimi:** Qëllimi i shërbimit do jetë blerje shërbimi, përgaditje e dokumentacionit dhe ricertifikimi ISO 14001, per kete arsye eshte i domosdoshëm nje përshkrim i përafërt të metodologjisë, planit të punës dhe afateve kohore për zbatimin e kontratës, duke përfshirë udhëtimet ne NJO, nënstacionet e OST sh.a, duhet të realizoje asistimin dhe përgatitjen e dokumentacioneve. Ky kriter eshte bazuar ne nenin 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

*2.3.6 Ne funksion te plotesimit te Shtojces 9 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise,*

*Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.*

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe nderkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.*